

## SHPALLJE VETEM PËR NËPUNËS CIVILË, LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË

**Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Shëndetësisë dhe  
Mbrotjes Sociale, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe  
Analizave Ndërsektoriale, Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit  
Statistikor, Instituti i Statistikave.**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të kreut II dhe III, të vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Instituti i Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, Drejtoria e  
Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale, Drejtoria e Përgjithshme e  
Prodhimit Statistikor, Instituti i Statistikave – kategoria III-1**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

**Afati për dorëzimin e dokumentave për  
LËVIZJE PARALELE:**

**2 Dhjetor 2025**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për  
NGRITJE NE DETYRE:**

**6 Dhjetor 2025**

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

Përgjegjësi i i Sektorit të Statistikave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përgjigjet tek Drejtori i Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale, për kryerjen e aktiviteteve statistikore dhe jostatistikore sipas planit operacional të dakordësuar dhe Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare. Gjithashtu ai përgjigjet për llogaritjen e treguesve në përgjegjësi të sektorit sipas PSZ së miratuar.

### **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë së ulët drejtuese;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/ Sociale /Statistikë. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

#### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë bashkë me kërkesën duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;
- b- Letër motivimi;
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor); Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- j- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive, leter reference apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda datës **2 Dhjetor 2025**.

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **4 Dhjetor 2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave, *(nëpërmjet adresës së e-mail)*, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” ([http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018\\_per-statistikat-zyrtare.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf));
2. Ligji nr.152/2013, “Për Nëpunësit Civil” ([Për Shërbimin Civil \(dap.gov.al\)](http://www.dap.gov.al));
3. Njohuri mbi Statistikat e Shkaqeve të Vdekjeve (<https://www.instat.gov.al/sq/temat/kushtet-sociale/shendetesia/publikimet/2025/shkaqet-e-vdekjeve-2024/>);
4. Njohuri mbi Statistikat e Shëndetit Publik (<https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/sh%C3%ABndet%C3%ABsia/#tab3>);
5. Njohuri për treguesit administrative të Mbrojtjes Sociale (<https://www.instat.gov.al/sq/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab4>);
6. Njohuri mbi manualin metodologjik të ESSPROS ([European System of integrated Social PROtection Statistics \(ESSPROS\) Manual and User guidelines](http://www.eurostat.ec.europa.eu/esspros));
7. Njohuri mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe Problemeve të Lidhura me Shëndetin (<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/03/20/135/b4f89874-a74f-47b9-bedb2ae7cecdfd88;q=icd%2010>);
8. [EU regulation 1338/2008](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32008R1338) për Statistikat mbi shëndetin publik, sigurinë dhe shëndetin në punë, e miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në Dhjetor 2008;
9. [EU regulation 2018/255](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32018R255) mbi statistikën e bazuara në Anketën Evropiane të Shëndetit (EHIS);
10. Shkaqet e vdekjeve: [EU regulation 328/2011](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32011R328) mbi statistikën për shkaqet e vdekjes;

11. Njohuri mbi [EU regulation 458/2007](#) Rregullorja (EC) Nr 458/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 Prill 2007 mbi Sistemin Evropian të Statistikave të Mbrojtjes Sociale të Integruar (ESSPROS);
12. Njohuri mbi [EU regulation 1322/2007](#) Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1322/2007 e 12 Nëntorit 2007 që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 458/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Sistemin Evropian të Statistikave të Mbrojtjes Sociale të Integruar (ESSPROS), sa i përket formateve të duhura për transmetim, rezultateve që duhet të transmetohen dhe kriterëve për matjen e cilësisë për sistemin bazë të ESSPROS dhe modulën mbi përfituesit e pensioneëve;
13. Njohuri mbi [EU regulation 263/2011](#) Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 110/2011, datë 8 Shkurt 2011, që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 458/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi sistemin evropian të statistikave të mbrojtjes sociale të integruar (ESSPROS), sa i përket formateve të duhura për transmetimin e të dhënave, rezultateve që duhet të transmetohen dhe kriterëve për matjen e cilësisë për modulën ESSPROS mbi përfitimet neto të mbrojtjes sociale;
14. Njohuri mbi [EU regulation 110/2011](#) Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 263/2011, datë 17 mars 2011, që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 458/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi sistemin evropian të statistikave të mbrojtjes sociale të integruar (ESSPROS), sa i përket nisjes së mbledhjes së plotë të të dhënave për modulën ESSPROS mbi përfitimet neto të mbrojtjes sociale;
15. Njohuri mbi Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015.  
<https://www.instat.gov.al/sq/sdgs/>.

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë mbi fushën e njohurive, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
  - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
  - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2 NGRITJA NË DETYRË**

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Institutit të Statistikave, duke filluar nga data **16.12.2025**.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë ekzekutive.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/ Sociale /Statistikë. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion;
- Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;
- b- Letër motivimi;
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor); Diplomën që janë marrë jashtë vendit,

duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- j- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive, leter reference apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brenda datës **6 Dhjetor 2025**.

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Duke filluar nga data **16 Dhjetor 2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të shpallë në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4**

[Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:](#)

- a- Njohuritë mbi fushën e njohurive, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

[Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:](#)

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Drejtoria e Burimeve Njerëzore në INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Institutit të Statistikave, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Institutit të Statistikave duke filluar nga data **16/12/2025**.

